

Njoftim për përqendrim me të cilin SKES Investment 17 S.à.r.l., Luksemburg, do të fitojë kontroll mbi Swixx Biopharma Holding AG, Zvicër (lënda nr. 08-23/2026)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 22.01.2026, dhe i plotësuar më 27.01.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar një njoftim për përqendrim me të cilin SKES Investment 17 S.à.r.l. (SKES Investment 17 S.à.r.l.), me seli të regjistruar në Place de la Gare 5, L-1616 Luksemburg, Luksemburg, do të fitojë kontroll të pavarur mbi shoqërinë Swixx Biopharma Holding AG (Swixx Biopharma Holding AG), me seli të regjistruar në Neuhofstrasse 5A, 6340 Baar, Zvicër.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

SKES Investment 17 S.à.r.l. është një shoqëri me qëllim të posaçëm, e themeluar ekskluzivisht për qëllimet e transaksionit të propozuar. E njëjta nuk ushtron aktivitete të tjera afariste.

SKES Investment 17 S.à.r.l. kontrollohet në mënyrë indirekte nga fonde të menaxhuara dhe të këshilluara nga shoqëri të lidhura me SK Capital Partners L.P. (SK Capital Partners L.P.; “SK Capital”).

SK Capital është një shoqëri private investimesh me seli në SHBA, e fokusuar në sektorët e materialeve të specializuara, industrisë kimike dhe farmaceutike. SK Capital është themeluar në vitin 2007 dhe ka seli në Nju Jork, SHBA, me zyrë edhe në Miami, Florida, SHBA. Ajo vepron në nivel global përmes shoqërive të saj të portofolit, me fokus të veçantë në Amerikën e Veriut, Zonën Ekonomike Evropiane (ZEE), Lindjen e Mesme dhe Australi.

Shoqëritë e portofolit të SK Capital nuk kanë prani të regjistruar dhe as të ardhura të realizuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Swixx Biopharma Holding AG është aktive në komercializimin e produkteve farmaceutike të gatshme në formë dozimi për kompani farmaceutike – palë të treta. Swixx Biopharma Holding AG operon në disa shtete të Evropës Qendrore dhe Lindore, Greqi, Euroazi, disa ish-republika sovjetike, Lindjen e Mesme dhe Amerikën Latine. Kryesisht furnizon produkte për kompani biofarmaceutike, produkte që shiten pa recetë (OTC) dhe kompani të pajisjeve mjekësore në këto tregje.

Grupi Swixx ka prani të regjistruar në Maqedoninë e Veriut përmes një shoqërie të varur:

AMICUS PHARMA SHPKNJP. Shkup, me seli të regjistruar në Bulevardi Partizanski Odredi nr. 62, lamela C, Shkup – Karposh, me veprimtari prioritare të regjistruar 73.11 – Agjenci reklamimi.

Në Maqedoninë e Veriut, Swixx Biopharma është aktive në shitjen e produkteve farmaceutike në formë dozimi, në fushat e onkologjisë, sëmundjeve kardiovaskulare, sëmundjeve të rralla, endokrinologjisë, vaksinave, dermatologjisë, sistemit nervor qendror, osteoporozës, barnave antiinfektive, hematologjisë, gastroenterologjisë dhe transplantologjisë.

Sipas parashtruesit të njoftimit, tregu relevant për përqendrimin në fjalë mund të përkufizohet si tregu i komercializimit dhe shpërndarjes së produkteve farmaceutike.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar lidhur me këtë çështje mbetet i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtje dhe mendime lidhur me këtë përqendrim. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup, ose në e-mail: kzk@kzk.gov.mk, dhe duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

28.01.2026

Shkup